

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Have Haliti kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi e Tonka Berishaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.N. për shkak të veprave penale Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 par.1 nënpar.4 dhe 9 lidhur me nenin 20 të KPRK-së, dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit H.N. të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.373/2017 datë 12.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 26.07.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit H.N., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.373/2017 datë 12.03.2018, vetëm përkitazi me vendimin për dënim dhe kualifikimit juridik të veprës penale nën pikën II të aktgjykimit, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës të akuzuarit H.N. për veprën penale nën pikën I të aktgjykimit e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 15.02.2017 e tutje, ndërsa për veprën penale nën pikën II të aktgjykimit e bënë ricilësimin e veprës penale në veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe për këtë vepër penale i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër tjetër penale. Pjesa tjetër e aktgjykimit mbetet e pa ndryshuar.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.373/2017 datë 12.03.2018, H.N. është shpallur fajtor për shkak të veprave penale Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 par.1 nënpar. 4 dhe 9 lidhur me nenin 20 të KPK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së. Gjykata të akuzuarit i ka shqiptuar : për veprën penale nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 6(gjashtë) muaj, ndërsa për veprën penale nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1

(një) viti. Konform nenit 80 të KPRK-së gjykata të akuzuarit i ka shqiptuar dënim unik në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite. Në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 15.02.2017 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, por jo më gjatë se sa dënimi i shqiptuar. Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore ta paguajë shumën aq sa do të bëhet sipas fletëshpenzimes së gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi merr formën e prerë. I dëmtuari F.A. ka deklaruar se nuk do të ushtrojë kërkesë pasurore-juridike.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

- Mbrojtësi i të akuzuarit H.N., av.G.B. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPPRK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënim me propozim që Gjykata e Apelit ankesë ta aprovojë si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim, ose aktgjykimin ta ndryshojë dhe të akuzuarin H.N. ta lirojë nga akuza, ose në rastin më të pavoritshëm ti shqiptojë një dënim më të butë.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I nr.264/18, të dt. 11.06.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit H.N., ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës e caktoi dhe e mbajti seancën kolegjit konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPP, për të cilën i njoftoj palët në mënyrë të rregullt, në mënyrë të rregullt. Në seancë nuk prezantuan Prokurori i Apelit, dhe i dëmtuari F.A., ndërsa prezantuan i akuzuari H.N. si dhe mbrojtësi i tij av.G.B.. Avokat G.B. mbeti pranë pretendimeve ankimore me shkrim ndërsa i akuzuari mbështeti ankesën e mbrojtësit të tij.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e kësaj lënde, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore konstatoi:

-se aktgjykimi duhet ndryshuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.N., av.G.B. ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 lidhur me nenin 370 par.7 të KPPRK-së, pasi konsideron se aktgjykimi është i pakuptueshëm, kundërthënës me brendinë e tij e sidomos kundërthënës me faktet vendimtare. Pretendohet se nga dëshmia e dëshmitarëve dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës nuk arrihet të vërtetohet se në të vërtetë i akuzuari është kryesi i veprës penale, kjo për faktin se në mes dëshmive të dëmtuarit dhe ato të dëshmitarëve ka kundërthënje në atë se i akuzuari a ishte prezent natën kritike. Aktgjykimi ankimohet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi pretendohet se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari është parë apo ka qenë natën kritike në vendin e ngjarjes, sipas pretendimeve të të dëmtuarit. Sa i përket shkeljes së ligjit penal, mbrojtja pretendon se gjykata e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar të akuzuarin për veprën penale Mbrojtja në pronësi, kontroll posedim ose shfrytëzim

të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. Të KPK-së, sipas ligjit që ka qenë në fuqi kur i akuzuari konsiderohet se e ka kryer veprën penale. Megjithatë, prej kohës kur konsiderohet se është kryer vepra penale është ndryshuar Kodi Penal dhe vepra penale e sanksionuar me nenin 328 par.2 të KPK-së, tani me Kodin e ri sanksionohet me dispozitën e nenit 374 par.1 të KPRK-së , e që krahasuar me kodin e vjetër, sanksioni është më i butë. Mbrojtja ankimon aktgjykimin e shkallës së parë edhe për shkak të vendimit mbi dënimin, duke theksuar se me shkeljen e dispozitave esenciale , vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, edhe dënimi është i pa bazuar dhe pa arsytuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar dhe analizuar me vëmendje ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av.G.B., konstaton se aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kushtëzojnë anulimin e aktgjykimit pasi aktgjykimi është i qartë dhe konkret, gjykata ka dhënë arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, janë paraqitur drejtë dhe qartë faktet dhe arsyet për të cilat është vërtetuar një gjendje faktike si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë. Është vlerësuar saktësia e provave kundërthënëse si dhe arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve si dhe gjykata ka dhënë arsyet në të cilat është bazuar kur ka zgjidhur këtë çështje penalo-juridike veçanërisht kur ka vërtetuar ekzistimin e veprës penale si dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit. Sa i përket gjendjes faktike i dëmtuari F.A. përkitazi me vendin, kohën, mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale ka qenë i qartë dhe konkret dhe se dëshmia e tij është në harmoni të plotë edhe me provat tjera dhe atë me dëshminë e ekspertit mjeko ligjor dr.N.U. lidhru me dëmtimet e pësuarra të dëmtuarit F.A., dëshminë e dëshmitarit F.Sh. kundër të tjera ka deklaruar se ka dëgjuar tri krisma ditën kritike, se e ka vërejtur të dëmtuarin të shtrirë në dysheme me trup dhe kokë nga dera, ka vërejtur një veturë Golf 2 e që ka një kalimtar i rastit ka dëgjuar se nga ajo veturë është gjuajtur. Po ashtu është në përputhje edhe me dëshminë e dëshmitarit H.P. ku ndër të tjera vërtetohet se kur ka hyrë në lokal i akuzuari Hamdi i është afruar derës së lokalit dhe ne një afërsi prej një hapi nuk e ka hapur fare derën e lokalit dhe me kallash ka filluar të gjuajë edhe pse arma nuk i kujtohet a ka qenë kallash por e din se ka qenë armë e gjatë, se të gjitha krismat kanë shkuar nga ana e H. dhe se i dëmtuari F. është rrëzuar në tokë duke i thënë ta thërras policinë dhe se me një person që ka qenë brenda në lokal me veturën e tij e ka dërguar në spital. Është i sigurtë se ka qenë H. pasi të njëjtin e ka njohur edhe para këtij rasti. Edhe me dëshminë e dëshmitarit G.A., dëshmia e të dëmtuarit F. është në përputhje të plotë, nga e cila dëshmi u vërtetua se i njëjti shoqërohet me J.N. që ka lidhje me R.N. dhe se para J. i ka dërguar njerëz për tu pajtuar por i njëjti nuk ka pranuar dhe vazhdimisht ka thënë se do të hakmerret, se nuk e din pse ka ardhur deri te plagosja e H. nga ana e F.it në atë kohë, se vonë e ka kuptuar se vajza që ka punuar me vajzën e tij si frizere ka qenë e familjes N.u, gjegjësisht vajza e R.t dhe se nuk e ka ditur se ka pasur lidhje me djalin e tij F.in dhe se H. e ka njohur vetëm pas rastit kur është plagosur nga djali i tij F.. Po ashtu dëshmia e të dëmtuarit është në përputhje edhe me provat materiale siç është raporti vendit të ngjarjes i datës 26.12.2011, lista e dëshmimeve e datës 26.12.2011, ekspertiza e njësisë për ekspertimin e armëve të zjarrit e datës 07.03.2012, dosja e hetimeve dhe provave me numër 2011-AC-2173, ku nga këto dëshmi vërtetohet se janë gjetur gëzhojat e fishekut në vendin e ngjarjes, njolla gjaku, xhami i derës së lokalit i thyer , gëzhojat e gjakut me mbishkrimet si në aktgjykim të shkallës së parë e që vërtetojnë se i akuzuari H.N.

është kryes i kësaj veprë penale dhe se me të drejtë gjykata e shkallës së parë të njëjtin bazuar në këto prova e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë dhe se këto prova demantojnë pretendimet e mbrojtjes se i njëjti nuk ka qenë i interesuar të hakmerret ndaj F.it por ia ka lënë këtë punë drejtësisë, dhe se ai nuk e ka plagosur të dëmtuarin F.. Po ashtu ndryshimi i deklaratës së tij duke krijuar situatën se kinse ka qenë në Gjermani në kohën kur është kryer vepra penale, një alibi e tillë nuk mundi të mbështetej nga i akuzuari. Po ashtu gjykata e shkallës së parë i ka dhënë arsyet edhe sa i përket rrezikimit edhe të personave të tjerë gjegjësisht F.Sh. dhe H.P. për të cilën edhe kjo gjykatë e mbështetë duke konsideruar se duke pasur parasysh armën e zjarrit me të cilën është gjuajtur, rafalët e shkrepur, lokali brenda të cilit kanë qenë i dëmtuari dhe dëshmitarët F. dhe H. të cilët ishin jo më larg se dy metra nga tani i dëmtuari e sidomos dëshmitari Flamur i cili ishte i ulur dhe mbi kokën e tij ishte i dëmtuari duke e qethur tregojnë për rrezikun e personave që kanë qenë prezent me tani të dëmtuarin F..

Gjykata aprovoi ankesën e mbrojtësit të akuzuarit edhe përkitazi me ricilësimin e veprës penale në veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së , pasi që në kohën kur është zhvilluar shqyrtimi kryesor ka qenë në fuqi Kodi i Ri Penal i cili parashihet këtë vepër penale në nënin 374 par.1 të KPRK-së e që parashihet dënimi me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim deri në 5 (pesë) vite burgim e që në raport me dispozitën ligjore që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale është më i favorshëm për të akuzuarin.

Me që në këtë çështje penalo-juridike, nuk kemi shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, nuk kemi as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit e që do të kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit H.N. lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa është e bazuar. Mbrojtësi në ankesë ka theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk i ka arsyetuar mjaftueshëm dhe në masën e duhur rrethanat lehtësuese pasi që në rastin konkret në raport me të pandehurin qëndrojnë një varg rrethanash lehtësuese të cilat nuk janë vlerësuar në mënyrë të duhur ndërsa rrethanat rënduese vetëm janë përshkruar nga ligji. Kjo gjykatë duke vlerësuar rrethanat lehtësuese të cilat i ka vlerësuar edhe gjykata e shkallës së parë siç janë qëndrimi korrekt i të akuzuarit, mosha e re, mëparë i pa gjykuar si dhe faktin se nga kryerja e veprës penale ka kaluar një kohë relativisht e gjatë mbi gjashtë vite, aprovoi ankesën e mbrojtësit të akuzuarit H.N. duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë është i ashpër dhe se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Nga çka u tha më lart, e në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Procesmbajtësi,
Eroll Gashi

Kryetari i kolegjit – gjyqtarja,
1. Have Haliti

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi_____

3. Tonka Berishaj_____